

Miratohet krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës

Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën për financimin e projektit "Për Dhomën e Biznesit të Diasporës, krijimin dhe nxitjen e investimeve të Diasporës në Shqipëri dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës". Krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitorëve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese të tyre në atdhe.

Gjithashtu do të synojë të jetë një mjet efikas për nxitjen e investimeve në Shqipëri. Kjo strukturë e re ka si qëllim mbrojtjen e bizneseve shqiptare në Diasporë si dhe nxitjen e tyre për investime në Shqipëri. Sipas këtij vendimi, ky projekt do të financohet për 28 muaj me buxhet prej 9 000 000 (nëntë milionë) lekësh ndërsa fondet shtesë për projektin do të sigurohen nga donatorët dhe nga të ardhurat e fituara nga aktivitete të kësaj dhome.



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës raporton në nënkomisionin "Për Diasporën dhe Migracionin"



Në nënkomisionin "Për Diasporën dhe Migracionin", pjesë e Komisionit Parlamentar për "Politikën e Jashtme", për të informuar mbi veprimtarinë e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për vitin 2018. Ky është raportimi i parë që Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës bën në këtë nënkomision. Drejtoresha e Fondit znj. Soana Jaupllari prezantoi një pasqyrë të plotë të aktivitetit të kryer si dhe aktivitetet që institucion do të realizojë gjatë vitit 2019.

Busti i Skënderbeut vendoset në Karakurt të Ukrainës



Pjesëtarë të komunitetit shqiptar në Karakurt, Ukrainë pranë bustit të heroi kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut të vendosur pak ditë më parë në këtë qytezë. Por ky nuk është aktiviteti i vetëm. Komuniteti shqiptar në Ukrainë së fundmi ka marrë edhe mësim për vallet dhe këngët shqiptare nga artistët e Ansambllit Kombëtar Shqiptar, si pjesë e marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit.

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës vizitë në komunitetin shqiptar në Bullgari

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës znj. Eteleva Znj. Donika Hoxha dhe Ambasadori i Kosovës Z. Edon Cana ku u Kondi është duke zhvilluar një vizitë në komunitetin shqiptar në bisedua për marrëdhëniet mes tre shteteve si dhe projektet e Bullgari ku është takuar me Kryetaren e Bashkisë së qytetit përbashkëta që mund të realizohen lidhur me promovimin e turizmit Ivaylovgrad, Diana Ovcarova si dhe pjesëtarë të komunitetit dhe të vlerave kulturore të shqiptareve në fshatin Mandricë, ku shqiptar në Bullgari. Znj. Kondi gjithashtu mori pjesë edhe në jeton komuniteti shqiptarë prej vitit 1636. Pjesë e kësaj vizite ishte takimin e organizuar nga ambasadorja e Shqipërisë, edhe takimi me banorët e Mandricës, ku zonjat shqiptare të fshatit të veshura me kostume popullore kënduan këngë shqiptare.



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin Universitar për Biznes dhe Teknologji në Kosovë

Drejtoresha e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, znj. Soana Jaupllari nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Presidentin e Kolegjit Universitar për Biznes dhe Teknologji në Kosovë, z. Edmond Hajrizi. Interesi i përbashkët i të dyja institucioneve është krijimi i mjeteve për të promovuar bashkëpunimin konkret në fushën kërkimore shkencore, arsimore si dhe të inovacionit. Në kuadër të kësaj marrëveshje do ndërtohen dhe zbatohen projekte, programe dhe aktivitete në fushat e interesit.



Mbledhja e Komisionit Shqiptari-Kosovë për miratimin e teksteve



Më 22-23 korrik u zhvillua në Vlorë mbledhja e tretë e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta. Në këtë mbledhje u diskutuan dhe u hartuan standardet për tekstet e përbashkëta për Diasporën.